



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Nr. 1342/prot.

Tiranë, më 01.06.2020

Lënda: Kthim përgjigje

Z. TOMI FRASHËRI – KRYETAR
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP)
Rruga "Reshit Çollaku", Tiranë

I nderuar z. Frashëri,

Në vijim të shkresës suaj nr. 857/4 prot., datë 29.05.2020, administruar në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) me nr. 1342 prot., datë 01.06.2020, me anë të së cilës keni kërkuar mendim mbi disa ndryshime në Rregulloren nr. 47, datë 26.10.2017 "Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm", ju sqarojmë se:

Sikurse jeni në dijeni gjatë procesit të miratimit të ligjit nr. 92/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, janë hartuar edhe disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, por procesi i miratimit të të këtij projektligji është shtyrë dhe është ende në proces.

Disa nga ndryshimet e propozuara në ligjin organik nr. 97/2013 nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, lidhen edhe me ndryshimin e kompetencave të Këshillit të Ankesave nga organ këshillimor në organ vendimmarrës.

Duke qenë se këto ndryshime ende nuk janë bërë pjesë e ligjit të posaçëm nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, propozojmë që në pikën 9.2 të Aneksit "E" të Rregullores nr. 47, datë 26.10.2017 "...për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm", togfjalëshi "Për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s...", të ndryshohet me "...për zbatimin e kërkesave dhe/ose vendimeve të AMA-s...".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Gentian Sala